VENDIM
Nr. 13, datë 3.3.2014

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OST SHA PËR ZGJIDHJEN E MARRËVESHJEVE PËR PJESËMARRJEN NË TREG, TË LIDHURA NDËRMJET "CEZ TRADE ALBANIA" SHPK DHE OST SHA – OT DHE PËR TËRHEQJEN NGA TREGU I ENERGJISË TË "CEZ TRADE ALBANIA"

Në mbështetje të nenit 12 pika 3 të "Marrëveshjes për pjesëmarrje në treg", miratuar me vendimin nr. 47, datë 4.6.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.3.2014, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "OST" sh.a. për zgjidhjen e marrëveshjeve për pjesëmarrjen në treg, të lidhura ndërmjet "CEZ Trade Albania" sh.p.k. dhe OST sh.a. - OT, përkatësisht atë të nënshkruar në cilësinë e tregtuesit të energjisë elektrike dhe atë të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së OST sh.a. për zgjidhjen e "Marrëveshjes për pjesëmarrjen në treg", të lidhur ndërmjet "CEZ Trade Albania" sh.p.k. në cilësinë e tregtuesit të energjisë elektrike dhe OST sh.a. - OT.
2. Miratimin e kërkesës së OST sh.a. zgjidhjen e "Marrëveshjes për pjesëmarrjen në treg", të lidhur ndërmjet "CEZ Trade Albania" sh.p.k në cilësinë e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike dhe OST sh.a. - OT.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti